



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2018-01

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 8 prill 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Zëvendësimin ose
Vetëtërheqjen e Gjykatësit**

Gjykatësit të Vetëm:
Gjykatës Nikola Giju

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:
Luka Mishetiq

Prokurores së Specializuar:
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Kadri Veselit:
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:
Xhefri Roberts

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke marrë parasysh nenet 26(4), 31(2), (3) dhe 33(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullën 20(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Rregullorja” dhe “DHSK”), rregullën 5 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”) dhe nenin 10 të Kodit të Etikës Gjyqësore për Gjykatësit e Emëruar në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Kodi i Etikës Gjyqësore”), lëshon këtë vendim mbi Kërkesën/Kërkesat e Mbrojtjes së Thaçit për Zëvendësimin ose Vetëtërheqjen e Gjykatësit (përkatësisht, “Kërkesa” dhe “Kërkesa Alternative”; bashkërisht “Kërkesat”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 maj 2018, gjykatësi Nikola Giju u caktua Gjykatës i Vetëm “për të shqyrtuar kërkesat për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me to, të parashtruara nga Prokurori i Specializuar përpara ngritjes së aktakuzës dhe caktimit në vijim të një gjykatësi të procedurës paraprake në bazë të nenit 33(1)(a) të Ligjit”.²
2. Më 5 dhjetor 2023, gjykatësi Nikola Giju u zgjodh gjykatës në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (“GJPN”) dhe më 8 mars 2024 bëri betimin në GJPN.
3. Më 14 mars 2024, z. Hashim Thaçi parashtroi Kërkesat.
4. Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk u përgjigj.
5. Më 5 prill 2024, në një memorandum konfidencial, gjykatësi Nikola Giju i dorëzoi Kryetares njoftim të arsyetuar që nuk do të vetëtërhiqej.

II. PARASHTRIMET

6. Z. Thaçi kërkon që gjykatësi Giju të zëvendësohet si Gjykatës i Vetëm i procesit aktual, ose, si alternativë, të caktohet një panel prej tre gjykatësish për të vendosur për kërkesën e tij në përputhje me rregullën 20(3) të Rregullores.³ Në lidhje me Kërkesën për zëvendësimin e gjykatësit Giju, z. Thaçi parashtrohet se neni 31(3) i Ligjit ia ndalon gjykatësit angazhimin në çfarëdo punësimi tjetër profesional pasi është caktuar të ushtrojë funksionet në DHSK, për të ruajtur pavarësinë gjyqësore të gjykatësit.⁴ Sipas z. Thaçi, gjykatësit Giju i është dashur “të punojë paralelisht me dy Kryetarë, dy kalendarë pune e dy lloj detyrimesh e mandatesh”.⁵ Z. Thaçi thekson se për rrjedhojë, gjykatësi Giju ka përgjegjësi ndaj të dy gjykatave, që ndikon në pavarësinë e tij dhe në parimin se gjykatësit nuk marrin udhëzime “nga burime të tjera përveç atyre që mbulojnë veprimtarinë e tij gjyqësore brenda vetë Gjykatës”.⁶ Z. Thaçi argumenton më tej se duke filluar nga mesi i gushtit 2024, gjykatësi Giju do të angazhohet me një numër çështjesh gjyqësore në GJPN, për të cilat do të duhet të përgatitet paraprakisht dhe si rezultat nuk do të jetë i disponueshëm për proceset në DHSK.⁷

7. Për sa i takon Kërkesës Alternative, z. Thaçi kërkon që gjykatësi Giju të vetëtërhiqet “për arsye se detyrimi i pavarësisë sipas nenit 31 të Ligjit për DHSK-në, sipas të cilit duhet të jetë i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe të mos angazhohet në asnjë punësim tjetër profesional, nuk mund të vijojë të respektohet”.⁸ Z. Thaçi parashtrohet se rregulla 20(1) e Rregullores ia ndalon gjykatësit Giju pjesëmarrjen në çështje gjyqësore që mund të ndikojnë në pavarësinë gjyqësore të tij ose në integritetin e

³ Kërkesat, para. 6, 32, 33, 35 dhe 37.

⁴ Kërkesat, para. 21. *Shih gjithashtu* Kërkesat, para. 22, 24-27.

⁵ Kërkesat, para. 22.

⁶ Kërkesat, para. 22. *Shih gjithashtu* Kërkesat, para. 23.

⁷ Kërkesat, para. 28. *Shih gjithashtu* Kërkesat, para. 29-31.

⁸ Kërkesat, para. 33. *Shih gjithashtu* Kërkesat, para. 34.

procesit dhe, rrjedhimisht, kërkon që të caktohet një panel prej tre gjykatësish në përputhje me rregullën 20(3) të Rregullores.⁹

III. DISKUTIM

a) Kërkesa për Zëvendësim

8. Kërkesat e z. Thaçi në thelb bazohen në pretendimin se pavarësia e gjykatësit Giju mund të cenohet pas emërimit të tij si gjykatës në GJPN në mars 2024.

9. Në lidhje me Kërkesën e z. Thaçi për zëvendësimin e gjykatësit Giju, Kryetarja rikujton nenet 26(4) dhe 31(2) e (3) të Ligjit, si dhe nenin 10 të Kodit të Etikës Gjyqësore së bashku me rregullën 5 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve. Thelbi i neneve 26(4) dhe 31(2) e (3) të Ligjit mbështetet në supozimin për angazhimin e një gjykatësi në veprimtari ose punësim që ka të ngjarë të ndërhyjnë në funksionet gjyqësore të tij, çka për rrjedhojë ia bën të pamundur Kryetares të kryejë detyrën e saj për caktimin e gjykatësit përkatës. Rregulla 5 e Rregullores për Caktimin e Gjykatësve e mbështet këtë interpretim dhe përcakton se: “Kur [...] një gjykatës [...] është i paaftë të ushtrojë detyrën në një fazë të mëvonshme të procesit”, d.m.th. pas caktimit fillestar, “në vend të tij Kryetari cakton një gjykatës tjetër”. Rrjedhimisht, kompetenca e Kryetares për të zëvendësuar një gjykatës nuk mund të vihet në lëvizje, përveçse kur ky gjykatës nuk është më në gjendje të ushtrojë detyrat e veta si pasojë e angazhimit konkret në një veprimtari apo punësim tjetër.

10. Kjo nuk qëndron në rastin e gjykatësit Giju. Gjykatësi Giju do të fillojë të ushtrojë funksionet e tij gjyqësore në GJPN prej 19 gushtit 2024.¹⁰ Kjo do të thotë se, deri në atë kohë, gjykatësi Giju është i disponueshëm t’i kryejë detyrat e tij në DHSK. Rrjedhimisht, Kryetarja rrëzon Kërkesën në lidhje me zëvendësimin e gjykatësit Giju.

⁹ Kërkesat, para. 35, 37.

¹⁰ *Shih* ICC, ICC-01/14-185, Decision Assigning Judges to Divisions and Recomposing Chambers, 12 March 2024; *shih gjithashtu*, Kërkesat, para. 26.

b) Kërkesa Alternative për Heqjen e Gjykatësit Giju

11. Kryetarja vëren se, si alternativë, z. Thaçi kërkon caktimin e një paneli prej tre gjykatësish në përputhje me rregullën 20(3) të Rregullores, për të shqyrtuar kërkesën për vetëtërheqjen e gjykatësit Giju.¹¹ Në këtë kontekst, Kryetarja rikujton se kërkesat për vetëtërheqje mund të bëhen vetëm nga vetë gjykatësit.¹² Rrjedhimisht, Kryetarja kupton se Kërkesa Alternative është për heqjen e gjykatësit Giju dhe për këtë arsye do të vijojë në përputhje me rregullën 20(3) të Rregullores.

12. Kryetarja rikujton se perceptimi i papranueshëm i anshmërisë ekziston në ato raste kur rrethanat do të bënin që një vëzhgues objektiv dhe i informuar si duhet, të perceptonte në mënyrë të arsyeshme se ka anshmëri.¹³ Për çdo gjykatës merret si i mirëqenë një supozim i fortë për paanshmëri, i cili nuk mund të hidhet poshtë aq lehtë.¹⁴ I takon palës që pretendon se ka anshmëri që të paraqesë prova të besueshme dhe të mjaftueshme për ta hedhur poshtë këtë supozim, sepse asnjë gjykatës nuk mund të hiqet nga gjykimi i një çështjeje mbi bazën e pretendimeve të përgjithshme ose abstrakte të cilat nuk janë as të faktuara e as të hollësishme.¹⁵

13. Ky standard i lartë kërkohet sepse “ashtu sikurse çdo perceptim real për anshmërinë e një gjykatësi dëmton besimin në administrimin e drejtësisë, do të ishte po aq kërcënim i mundshëm ndaj interesave të administrimit të paanshëm dhe të drejtë të drejtësisë nëse gjykatësit do të hiqeshin nga gjykimi i çështjeve për shkak të pretendimeve të pabazuara dhe të pambështetura me prova për perceptim të anshmërisë”.¹⁶ Në fakt, nëse do të konstatohej ndryshe, do të cenohej aftësia e gjykatësve për të kryer detyrat e tyre në përputhje me mandatin e organit gjyqësor

¹¹ *Shih* Kërkesat, para. 37.

¹² *Krahaso* KSC-BC-2020-07, Vendim mbi Kërkesën për Vetëtërheqjen ose Heqjen e Gjykatësve, 6 gusht 2021 (“Vendimi mbi Heqjen e Gjykatësve”), para. 30.

¹³ Vendimi mbi Heqjen e Gjykatësve, para. 31.

¹⁴ Vendimi mbi Heqjen e Gjykatësve, para. 31.

¹⁵ Vendimi mbi Heqjen e Gjykatësve, para. 31.

¹⁶ Vendimi mbi Heqjen e Gjykatësve, para. 32- 33.

përkatës, përfshirë edhe DHSK-në, dhe kjo do të kishte një ndikim shumë negativ në administrimin e drejtësisë.

14. Siç u përmend më sipër, gjykatësi Giju është caktuar gjykatës në GJPN dhe do të thirret në selinë e gjykatës në shërbim me kohë të plotë vetëm duke filluar nga 19 gushti 2024.¹⁷ Me fjalë të tjera, çdo argument i z. Thaçi në lidhje me disponueshmërinë e gjykatësit Giju dhe ndikimin që emërimi i tij si gjykatës në GJPN mund të ketë mbi efikasitetin e procesit në DHSK, është i parakohshëm. Për rrjedhojë, sugjerimet e z. Thaçi për veprimtarinë profesionale që gjykatësit Giju mund t'i duhet të kryejë ose jo si gjykatës i GJPN-së para marrjes së detyrës në gusht 2024 dhe aftësinë e tij për të ushtruar funksionet e Gjykatësit të Vetëm në DHSK, janë hamendësuese. Z. Thaçi nuk ka paraqitur asnjë argument se emërimi i gjykatësit Giju si gjykatës në GJPN në mars 2024 ka ndikuar në punën e tij apo ka ngadalësuar procesin ku është caktuar si Gjykatës i Vetëm.

15. Duhet ritheksuar gjithashtu se është krejtësisht brenda kompetencave të Kryetares të shqyrtojë, në këshillim me gjykatësin, disponueshmërinë e tij dhe për rrjedhojë, të vendosë nëse do ta caktojë që të ushtrojë detyra në DHSK. Kryetarja rikujton gjithashtu se vendime të tilla janë administrative dhe nuk mund të apeloher nga palët.¹⁸ Për rrjedhojë, vendimet që merr Kryetarja në lidhje me disponueshmërinë e gjykatësve për të ushtruar detyrat zyrtare nuk mund të kundërshtohen nga ky aspekt.

16. Duke iu kthyer argumenteve të z. Thaçi që kundërshtojnë pavarësinë e gjykatësit Giju, Kryetarja vëren se z. Thaçi nuk ka paraqitur asnjë argument që tregon se si emërimi i gjykatësit Giju si gjykatës në GJPN ndikon ose do të ndikojë në pavarësinë e tij sa i takon procesit në lidhje me z. Thaçi. Në fakt, përtej pretendimeve

¹⁷ *Shih* ICC, ICC-01/14-185, Decision Assigning Judges to Divisions and Recomposing Chambers, 12 March 2024.

¹⁸ *Krahaso* Vendimin mbi Heqjen e Gjykatësve, para. 21-22.

të përgjithshme që sugjerojnë se gjykatësi Giju nuk mund të konsiderohet i pavarur për shkak të emërimit të tij si gjykatës në GJPN dhe pretendimit se ai do të marrë udhëzime nga Kryetarë të dy institucioneve të ndryshme, z. Thaçi nuk përmend asgjë konkrete apo specifike që demonstroi (perceptim për) anshmërinë e gjykatësit Giju në lidhje me procesin gjyqësor të z. Thaçi.

17. Kryetarja gjithashtu thekson në këtë kontekst se z. Thaçi nuk paraqet argumente se si pozita gjyqësore e gjykatësit Giju në GJPN – juridiksioni i së cilës nuk përkon me atë të DHSK-së – mund të ndikojë në pavarësinë e tij.¹⁹ Po kështu, z. Thaçi nuk demonstroi se çfarë udhëzimesh, në rast se do të kishte të tilla, do të merrte gjykatësi Giju nga dy Kryetarët – përveç atyre që lidhen me aspekte administrative ose caktimin në çështje gjyqësore – që nuk do të kishin ndikim në pavarësinë e gjykatësit Giju.²⁰ Në vend të kësaj, z. Thaçi ngatërron argumentet për disponueshmërinë e gjykatësit Giju - që është aspekt administrativ dhe shqyrtohet nga Kryetarja - me pavarësinë gjyqësore të gjykatësit Giju.²¹

18. Sikurse theksohet më lart, disponueshmëria e gjykatësit Giju për të ushtruar funksionet e Gjykatësit të Vetëm është aspekt administrativ dhe i takon Kryetares ta vlerësojë atë. Kryetarja rrjedhimisht konstaton se Kërkesa Alternative e z. Thaçi për heqjen e gjykatësit Giju si Gjykatës i Vetëm është e pabazë dhe e hedh poshtë atë me procedurë të shkurtuar.

¹⁹ *Shih* Kërkesat, para. 22.

²⁰ *Shih* Kërkesat, para. 22.

²¹ *Shih* Kërkesat, para. 23-32.

IV. VENDIM

19. Bazuar në sa më sipër, Kryetarja:

- a. **RRËZON** Kërkesën për zëvendësimin e gjykatësit Giju; dhe
- b. **HEDH POSHTË ME PROCEDURË TË SHKURTUAR** Kërkesën Alternative për heqjen e gjykatësit Giju si tërësisht të pabazë.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E hënë, 8 prill 2024

Në Hagë, Holandë.